



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.75/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista, me seli në Graçanicë, për shkak të vendosjes se posterit në hapësirat publike përkatësisht në shtylla publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07 .06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), kështu që subjekti politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista (SP GISL), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1,500.00 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 05.06.2017 nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017, ka vërejtur se në rrugën Princi Lazër në Graçanicë, monitoruesi e ynë ka hasur në posterin e kandidatit për deputet nga subjekti politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista ,të vendosur në hapësirat publike konkretisht në shtylla publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1,pika b),të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr.03/L-073 duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur posterin në hapësirë publike. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur1(një)fotografin të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista, të datës 06.06.2017 thekson se do te respekton LPZ-në, rregullën zgjedhore nr.11/2013, kodin e mirësjelljes për subjektet politike dhe do të zhvilloj një procedurë të hetimit dhe vërtetimit nesh dikush nga aktivistët sipas gjitha gjasave për shkak të mos dijës, kanë vendosur postere në vendet ku nuk lejohet vendosja e tyre. SP GISL me datë 06.06.2017, ka ndërmarrë masat konkrete dhe ka urdhëruar aktivistët të saj që të largojnë të gjitha postaret nga vendet kur nuk lejohet. Duke marrë parasysh veprimet e ndërmarra ju lusim qe te pranoni kërkesën tonë dhe që të mos shqiptohet gjob apo sanksion ndaj SPGI Srpska Lista, po ashtu kemi bashkangjitur kërkesës fotografën nga vendi. Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se postieri i kandidatit për deputet në fushatën zgjedhore i subjekti politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista, është vendosur në rruge publike e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstatoi se nga provat e ofertuar shihet qartë se nga subjekti politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista, është shkelur neni 33, pika b) të LPZ-së pasi që postieri i kandidati për deputet nga subjekti politik në fjalë janë vendosur ne objektin e hapësirave publike të qytetit të cilën shkeljen e ka pranuar edhe subjekti politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista, në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti se posteri i kandidatit për deputet është vendosur në hapësira publik.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin se subjekti politik në fjalë, ia dha mundësin për tu përgjigjur ashtu që në përgjigje e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartasin e gjobës së shqiptuar si në dispozitivin të këtij vendimi

Nga të dhënat e cekura si më lart Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.75 /2017 më datën 07.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.